

V E N D I M
Nr.424, datë 26.6.2003

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ENERGJISË DERI NË VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë deri në vitin 2015, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda datës 1.9.2003, planin e përbashkët të veprimeve me institucionet përkatëse, për zbatimin e kësaj strategjie.
 3. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, që, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Energjisë, të bëjë çdo dy vjet azhurnimin e kësaj strategjie dhe t'ia paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave.
 4. Ngritjen e grupit ndërinstitutional dhe të grupit teknik, nën drejtimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, që të monitorojnë zbatimin e kësaj strategjie dhe të raportojnë, pranë Komitetit Ndërmintor të Energjisë, për rezultatet dhe problemet e vëna re.
 5. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano